



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 433 , datë 26.6.2019

PËR

**FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT**  
**TË VEPRIMTARISË SË QENDRËS KOMBËTARE**  
**TË VEPRIMTARIVE TRADICIONALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së zhvillimit të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (në vijim, QKVT).
2. QKVT-ja është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë.
3. QKVT-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.
4. QKVT-ja ka për mision administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin dhe promovimin e pasurive kulturore jomateriale e të diversitetit kulturor në nivel kombëtar, në bashkëpunim me subjekte publike e private.
5. QKVT-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë vijon:

- a) Trashëgimi kulturorë jomateriale;
- b) Diversitet kulturor.

## **II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE TRADICIONALE**

1. QKVT-ja ka përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

- a) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë në fushën e trashëgimisë kulturorë jomateriale lidhur me kushtet për rritjen e ndërgjegjësimin për ruajtjen e promovimin e saj;
- b) Të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë në fushën e diversitetit kulturor në nivel kombëtar.

## **III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË VEPRIMTARIVE TRADICIONALE**

- 1. QKVT-ja e shtrin veprimtarinë e saj për trashëgiminë kulturorë jomateriale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.
- 2. QKVT-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e QKVT-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturorë.
- 3. Struktura dhe organika e QKVT-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
- 4. QKVT-ja funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturorë dhe muzetë, të këtij vendimi dhe statutit e të rregullores së miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturorë.
- 5. QKVT-ja realizon aktivitetin e saj në bashkëpunim me:
  - a) institucionet e tjera publike në varësi të ministrisë përgjegjëse të trashëgimisë kulturorë, organet e administratës qendrore, organet e qeverisjes vendore dhe institucione të tjera shkencore, kulturorë, fetare, persona fizikë e juridikë për administrimin, studimin, kërkimin, evidentimin, ruajtjen, mbrojtjen, popullarizimin e promovimin e pasurive kulturorë jomateriale dhe të diversitetit kulturor në nivel kombëtar.



- b) UNESCO-n dhe me organizata të tjera ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, promovimin e identitetit kulturor, si dhe ndërmerr nisma për njohjen e regjistrimin në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale;
  - c) institucione të tjera të specializuara të sistemit të Akademisë së Shkencave, Akademisë së Studimeve Albanologjike, universiteteve përkatëse, si dhe institucione homologe ose organizma ndërkombëtarë në fushën e trashëgimisë kulturore.
6. Statuti dhe rregullorja, që përcaktojnë metodat e brendshme të punës së QKVT-së miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
  7. Marrëdhëniet e punës së drejtorit, nëpunësve dhe të punonjësve të QKVT-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
  8. Drejtori i QKVT-së emërohet ose lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet në statutin e QKVT-së.
  9. Drejtori i QKVT-së duhet të plotësojë kriteret profesionale, si më poshtë vijon:
    - a) Të ketë eksperiencë profesionale e të dokumentuar në fushën e tij të ekspertizës dhe të menaxhimit;
    - b) Nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale.
  10. QKVT-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:
    - a) Asiston ministrinë në ushtrimin e kompetencave të saj për zbatimin e politikave qeveritare në fushën e ruajtjes, mbrojtjes, promovimit dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore jomateriale;
    - b) Kërkon, verifikon dhe studion vlerat e trashëgimisë kulturore jomateriale;
    - c) Krijon dhe përditëson Regjistrin Kombëtar të Bartësve të Folklorit, Regjistrin e Vlerave të Trashëgimisë Jomateriale, listën e artizanëve, të cilët trashëgojnë dijetë të ndryshme, Regjistrin e Kryeveprave të Trashëgimisë Jomateriale dhe listën e trashëgimisë kulturore jomateriale në rrezik;
    - ç) Krijon dhe mirëmban një hartë interaktive të trashëgimisë kulturore jomateriale në territorin e Republikës së Shqipërisë;

- d) Lëshon dokumente, kopje të vërtetuara të tyre dhe kopje digjitale të arkivit, sipas tarifave të përcaktuara me udhëzim;
- dh) Monitoron në terren të gjitha veprimtaritë e trashëgimisë jomateriale, që zhvillohen në rang vendi;
- e) Përgatit raporte apo informacione për trashëgiminë jomateriale, të kërkuara nga organizmat ndërkombëtarë, dhe i paraqet ato pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale;
- ë) Bashkëpunon me specialistët e trashëgimisë kulturore jomateriale pranë drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore, si dhe me institucionet kulturore-artistike, qendrore e vendore, shoqatat kulturore e individë të fushës së trashëgimisë jomateriale;
- f) Organizon festivalet folklorike tipologjike kombëtare në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- g) Organizon Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera shtetërore e private, bazuar në rregulloren e tij, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
- gj) Propozon, për miratim, pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, “Kryevlerat Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”;
- h) Nxjerr vendimin për konstatimin ose jo të interesit kulturor të pasurisë kulturore jomateriale, objekt verifikimi, në zbatim të nenit 58, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pas vendimit të komisionit këshillimor;
- i) Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, merr masa dhe krijon kushte lehtësuese për promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale jashtë kufijve të vendit, të grupeve apo bartësve popullorë, për pjesëmarrje në turne, festivale apo takime ndërkombëtare të kësaj fushe.

11. Drejtori i QKVT-së ka kompetencat dhe përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

- a) Analizon, zbërthen dhe siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- b) Është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike, në përputhje me objektivat dhe misionin e QKVT-së;
- c) Planifikon, drejton e koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
- ç) Është sekretar i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale;



- d) Jep udhëzime lidhur me trajtimin e kërkesave që i kalojnë për shqyrtim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale;
  - dh) Identifikon mundësitë për menaxhim të fondeve publike dhe të performancës së institucionit;
  - e) Ndjek e raporton zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga konventat, protokollet dhe marrëveshjet një-ose shumëpalëshe;
  - ë) Bashkërendon punën me institucionet monitoruese, me qëllim që konkluzionet dhe rekomandimet e monitorimit të përfshihen në programet dhe politikat që ndjek ministria;
  - f) Emëron dhe shkarkon punonjësit e QKVT-së në bazë të Kodit të Punës dhe të rregullores së brendshme të QKVT-së.
12. QKVT-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e QKVT-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale”.
  13. Vula e QKVT-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale miratohet me urdhër të Kryeministrit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Statuti i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale miratohet nga ministri i Kulturës, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë, të miratimit të strukturës dhe organikës së Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale, sipas këtij vendimi, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike vazhdon të kryejë funksionet e saj sipas strukturës dhe organikës në fuqi.
4. Punonjësit aktualë të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike riorganizohen sipas strukturës dhe organikës së re të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale. Ky proces udhëhiqet nga Ministria e Kulturës dhe zbatohet nga QKVT-ja, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Punës.

5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, që, në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike (QKVF) te Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT).
6. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

MINISTRI I KULTURËS

ELVA MARGARITI

